

**Data Efektive e Detyrueshme e Hyrjes në Fuqi të SNRF 9
dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese Kalimtare**

(Ndryshime në SNRF 9 (2009),
SNRF 9 (2010) dhe SNRF 7)

Ndryshime në SNRF 9 *Instrumentat Financiarë* (2009) dhe SNRF 9 *Instrumentat Financiarë* (2010)

Paragrafët 8.1.1 dhe 8.2.12 të SNRF 9 (2009) janë ndryshuar (teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar).

8.1 Data e hyrjes në fuqi

8.1.1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 Janar 2013⁵ e në vijim. Lejohet zbatimi i më hershëm i tij. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF për një periudhë më të hershme se 1 Janar 2013⁵, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe të zbatojë ndryshimet në Shtojcën C.

8.2 Dispozita Kalimtare

8.2.12 Pavarësisht nga kërkesa në paragrafin 8.2.1, një njësi ekonomike që zbaton këtë SNRF për periudhat raportuese;

- (a) që fillojnë më parë se 1 Janar 2012 nuk ka nevojë të riparaqesë periudhat e mëparshme- dhe nuk ka nevojë që ajo të paraqesë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 44S–44W të SNRF 7;
- (b) që fillojnë më 1 Janar 2012 ose më pas dhe më parë se 1 Janar 2013 duhet të zgjedhë nëse do të japë informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 44S–44W të SNRF 7 ose të riparaqesë periudhat e mëparshme; dhe
- (c) që fillojnë më 1 Janar 2013 duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 44S–44W të SNRF 7. Nuk ka nevojë që njësi ekonomike të riparaqesë periudhat e mëparshme.

Nëse një njësi ekonomike nuk riparaqet periudhat e mëparshme, ajo duhet të njohë çdo diferencë mes vlerës kontabël (neto) të mëparshme dhe vlerës kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese vjetore që përfshin datën e fillimit të zbatimit, në fitimet e mbartura të çeljes (ose përbërës tjetër të kapitalit neto, si të jetë më përshtatshme) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e fillimit të zbatimit.

Paragrafët 7.1.1, 7.2.10, 7.2.14 dhe 7.3.2 të SNRF 9 (2010) janë ndryshuar (teksti i fshirë është shënuar me vijë në mes dhe teksti i ri është nënvizuar).

7.1 Data e hyrjes në fuqi

7.1.1 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 Janar 2013⁵ e në vijim. Lejohet zbatimi i më hershëm i tij. Megjithatë nëse një njësi ekonomik zgjedh të zbatojë këtë SNRF më herët dhe ndërkohë nuk ka zatur SNRF 9 të publikuar në 2009, ajo duhet të zbatojë njëkohësisht të gjitha kërkesat këtij SNRF (shih gjithashtu paragrafin 7.3.2). Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë SNRF në pasqyrat e saj financiare për një periudhë që fillon më parë se 1 Janar 2013⁵, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe të zbatojë ndryshimet në Shtojcën C.

7.2 Dispozita Kalimtare

7.2.10 Nëse për një njësi ekonomike është i pamundur (sipas përcaktimit në SNK 8) zbatimi në mënyrë retrospektive i metodës së interesit efektiv ose i kërkesave për rënien në vlerë të paragrafëve 58–65 dhe AG84–AG93 të SNK 39, ajo do të trajtojë vlerën e drejtë të aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar në fund të çdo periudhe krahasuese si kosto të amortizuara në rast se njësi riparaqet periudhat e mëparshme. ~~Në këto rrethana~~ Nëse për një njësi ekonomike është i pamundur (sipas përcaktimit në SNK 8) zbatimi në mënyrë retrospektive i metodës së interesit efektiv ose i kërkesave për rënien në vlerë të paragrafëve 58–65 dhe AG84–AG93 të SNK 39, vlera e drejtë e aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar në datën e fillimit të zbatimit duhet të trajtohet si kosto e re e amortizuara e atij aktivitetit financiar ose pasivitetit financiar në datën e fillimit të zbatimit të këtij SNRF.

7.2.14 Pavarësisht nga kërkesa në paragrafin 7.2.1, një njësi ekonomike që zbaton kërkesat për klasifikim dhe matje të këtij SNRF për periudha raportuese;

- (a) që fillojnë më parë se 1 Janar 2012 nuk ka nevojë të riparaqesë periudhat e mëparshme- dhe nuk ka nevojë që ajo të paraqesë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 44S–44W të SNRF 7;
- (b) që fillojnë më 1 Janar 2012 ose më pas dhe më parë se 1 Janar 2013 duhet të zgjedhë nëse do të japë informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 44S–44W të SNRF 7 ose të riparaqesë periudhat e mëparshme; dhe
- (c) që fillojnë më 1 Janar 2013 duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 44S–44W të SNRF 7. Nuk ka nevojë që njësi ekonomike të riparaqesë periudhat e mëparshme.

Nëse një njësi ekonomike nuk riparaqet periudhat e mëparshme, ajo duhet të njohë çdo diferencë mes vlerës kontabël (neto) të mëparshme dhe vlerës kontabël (neto) në fillim të periudhës raportuese vjetore që përfshin datën e fillimit të zbatimit, në fitimet e mbartura të çeljes (ose përbërës tjetër të kapitalit neto, si të jetë më përshtatshme) të periudhës vjetore të raportimit që përfshin datën e fillimit të zbatimit.

7.3 Tërheqja e KIRFN 9 dhe SNRF 9 (2009)

7.3.2 Ky SNRF zëvendëson SNRF 9 të publikuar në 2009. Megjithatë për periudha vjetore që fillojnë më parë se 1 Janar 2013~~5~~, një njësi ekonomike mund të zgjedhë të zbatojë SNRF 9 të publikuar në 2009 në vend të zbatimit të këtij SNRF.

Ndryshime në SNRF 7 *Instrumentat Financiarë: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese*

Paragrafi 44I i SNRF 7 është ndryshuar.

- 44I Nëse një njësi ekonomike zbaton për herë të parë SNRF 9, ajo duhet të japë informacion shpjegues për secilën klasë të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare në datën e fillimit të zbatimit, për:
- (a) kategorinë fillestare të matjes dhe vlerën e mbartur të përcaktuar në përputhje me SNK 39;
 - (b) kategorinë e re të matjes dhe vlerën e mbartur të përcaktuar në përputhje me SNFR 9;
 - (c) madhësinë e ndonjë aktivi financiar dhe pasivi financiar të pasqyrës së pozicionit financiar që më parë ishin përcaktuar si të matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes por tashmë nuk përcaktohen si të tillë, duke bërë dallim mes atyre që njësia duhet të riklasifikojë sipas kërksave të SNRF 9 dhe atyre që ajo zgjedh të riklasifikojë.

Një njësi ekonomike duhet të paraqesë këto informacione shpjeguese sasiore në formë tabelle me përjashtim të rastit kur një format tjetër është më i përshtatshëm.

Në SNRF 7 janë shtuar paragrafët 44S–44W.

- 44S Nëse një njësi ekonomike zbaton për herë të parë kërkesat për klasifikim dhe matje të SNRF 9, ajo duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar në paragrafët 44T–44W të këtij SNRF nëse zgjedh ose nëse i kërkohet, me kushtin që kjo dhënie informacionsh shpjeguese të jetë në përputhje me SNRF 9 (shih paragrafin 8.2.12 e SNRF 9 (2009) dhe paragrafin 7.2.14 të SNRF 9 (2010)).

- 44T Nëse kërkohet nga paragrafi 44S, në datën e zbatimit për herë të parë të SNRF 9 një njësi ekonomike duhet të paraqesë informacion shpjegues mbi ndryshimet në klasifikim të aktiveve financiare dhe pasiveve financiare, duke treguar veçmas:

- (a) ndryshimet në vlerën kontabël (neto) bazuar në kategoritë e matjes në përputhje me SNK 39 (dmth që nuk vijnë nga një ndryshim në matje si pasojë e dispozitave kalimtare të SNRF 9); dhe
- (b) ndryshimet në vlerën kontabël (neto) që vijnë nga një ndryshim në matje si pasojë e dispozitave kalimtare të SNRF 9.

Nuk është e nevojshme që dhënie e informacioneve shpjeguese të këtij paragrafi të bëhen pas periudhës vjetore të zbatimit për herë të parë të SNRF 9.

- 44U Në periudhën raportuese në të cilën SNRF 9 zbatohet për herë të parë, një njësi ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim për aktivet financiare dhe pasivet financiare të riklasifikuara pra të matura me koston e amortizuar si pasojë e dispozitave kalimtare në SNRF 9:

- (a) vlerën e drejtë të aktiveve financiare ose pasiveve financiare në fund të periudhës së raportimit;
- (b) fitimin ose humbjen nga vlera e drejtë që do të ishte njohur në rezultat ose në të ardhurat e tjera totale gjatë periudhës së raportimit nëse aktivet financiare ose pasivet financiare nuk do të ishin riklasifikuar;
- (c) normën efektive të interesit në datën e riklasifikimit; dhe
- (d) shpenzimet ose të ardhurat e njohura nga interesi.

Nëse një njësi ekonomike trajton vlerën e drejtë të një aktivi financiar ose pasivi financiar si kosto të amortizuar të tij në datën e zbatimit për herë të parë (shih paragrafin 8.2.10 të SNRF 9 (2009) dhe paragrafin 7.2.10 të SNRF 9 (2010)), dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga pikat (c) dhe (d) të këtij paragrafi duhet të bëhet për secilën periudhë raportimi që pason riklasifikimin deri në mosnjohje. Në rast të kundërt nuk është e nevojshme që të bëhet dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ky paragraf pas periudhës së raportimit që përfshin datën e zbatimit për herë të parë.

- 44V Nëse një njësi ekonomike paraqet informacionet shpjeguese të kërkuara në paragrafët 44S–44U në datën e zbatimit për herë të parë të SNRF 9, këto dhe dhënie e informacioneve shpjeguese të paragrafit 28 të SNK 8 gjatë periudhës së raportimit që përfshin datën e zbatimit për herë të parë, duhet të lejojnë rakordimin mes:

- (a) kategorive të matjes në përputhje me SNK 39 dhe SNRF 9; dhe
- (b) zërave të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar.

44W Nëse një njësi ekonomike paraqet informacionet shpjeguese të kërkuara në paragrafët 44S–44U në datën e zbatimit për herë të parë të SNRF 9, këto dhe dhënie të informacioneve shpjeguese të paragrafit 25 të këtij SNRF në datën e zbatimit për herë të parë, duhet të lejojnë rakordimin mes:

- (a) kategorive të matjes në përputhje me SNK 39 dhe SNRF 9; dhe
- (b) klasës së instrumentave financiarë në datën e zbatimit për herë të parë.